



REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

---

**KUVENDI KOMUNAL PEJË**

**Komiteti për Politikë e Financa**

**I.Numër: 060/01-49293**

**Pejë, datë: 17.07.2025**

**PROCESVERBAL**

Nga takimi i VI-të i Komitetit për Politikë e Financa i KK-së Pejë, mbajtur me **17 korrik 2025**, në orën 10:00.

Takimi u mbajt në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit, z. Avni Gashi, zyrtare administrative znj. Donjeta Morina, dhe përfaqësuesit e OSCE-së dhe ZIP-it

Takimin e hapi dhe e udhëheqi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, i cili hapi diskutimin për rendin e ditës, dhe i sqaroi të gjitha pikat të cilat janë vendosur në rend dite.

Unanimishtë nga gjithë anëtarët prezent u miratua ky rend dite,

#### Rendi i Ditës

1. Aprovimi i rendit të ditës.
2. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalet të KPF-së: dt. 15.05.2025 dhe dt. 18.06.2025.
4. Shqyrtimi dhe rekomandimi i Nismës për bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Pejës nga Republika e Kosovës dhe Komunës së Buca nga Republika e Turqisë.
5. Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit të punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmujorin e parë 2025.
6. Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit të hyrave dhe shpenzimeve për gjashtëmujorin e parë, janar - qershor 2025.
7. Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Pejës për vitin 2024 dhe plani i veprimit për të gjeturat e auditimit të vitit 2024.
8. Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës nga DKA për përfundimin e vitit shkollor, testit të arritshmërsë dhe testit të maturës.
9. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar

#### **2.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.**

Nuk ka pasur.

#### **3. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalet të KPF-së: dt. 15.05.2025 dhe dt. 18.06.2025.**

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent, miratohen Procesverbalet të KPF-së: dt. 15.05.2025 dhe dt. 18.06.2025.

#### **4.Shqyrtimi dhe rekomandimi i Nismës për bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Pejës nga Republika e Kosovës dhe Komunës së Buca nga Republika e Turqisë.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: na ka ardh një konkluzion prej zyres së kryetarit për bashkëpunim komunal me komunën Buca nga Republika e Turqisë. Zhvillimi i mardhënjëve në mes dy komunave, rritja e mundësive të bashkpunimit, pjesëmarrja në aktivitete kultërore.

Z.Labinot Panxha: e kena mar vendim mbasi nuk janë këtu drejtorat prezent, nuk ja vlen as me diskutu!

Nga të gjithë anëtarët prezent 6 votë pro, 3 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim i rekomandohet kuvendit për shqyrtim Nisma për bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Pejës nga Republika e Kosovës dhe Komunës së Buca nga Republika e Turqisë.

**5.Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit të punës së Kryetarit të Komunës për gjashtë-mujorin e parë 2025.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: në seancën e kuvendit do të raportoj kryetari për punën e ekzekutivit për gjashtë-mujorin e parë.

Nga të gjithë anëtarët prezent 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim i rekomandohet kuvendit për shqyrtim, raporti i punës së Kryetarit të Komunës për gjashtë-mujorin e parë 2025.

**6.Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për gjashtëmujorin e parë, janar - qershor 2025.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: është një raport që ka ardh nga drejtoria e financave të cilin e kemi përcjellë me material. Nese ka dikush diqka rreth raportit të të hyrave dhe shpenzimeve për gjashtëmujorin e parë, e hapim diskutimin!

Nga të gjithë anëtarët prezent 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim i rekomandohet kuvendit për shqyrtim raporti financiar.

**7.Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Pejës për vitin 2024 dhe plani i veprimit për të gjeturat e auditimit të vitit 2024.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: po e përseris prap që pikat që i kemi për shqyrtim janë pikat që i kemi në plan të punës së kuvendit. Në momentin që e kemi votu planin e punës së kuvendit dhe pikat që ekzekutivi e ka për obligim me i paraqit para anëtarëve të kuvendit nuk i tejkalojmë. Ky material ka ardh për shkak të vonesës së raportit të auditimit dhe po ashtu edhe planin e veprimit për të gjeturat të auditimit nuk kanë mundur me u bo gati gjithësesi ne e kemi si pikë në rend dite me paraqit për shqyrtim.

Nga të gjithë anëtarët prezent 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim i rekomandohet kuvendit për shqyrtim raporti i auditimit.

**8.Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës nga DKA për përfundimin e vitit shkollor, testit të arritshëmirsë dhe testit të maturës.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: materiali na ka ardh nga drejtoria e arsimit si informatë dhe ju kemi përcjellë materialin me kohë. Nese ka dikush diqka rreth ketij materiali e hapim diskutimin për ketë pikë.

Nga të gjithë anëtarët prezent 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim i rekomandohet kuvendit për shqyrtim informata nga DKA për përfundimin e vitit shkollor, testit të arritshëmirsë dhe testit të maturës.

**9.Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar**

Nuk ka pasur.

*Pjesë e këtij procesverbali është edhe audio incizimi i këtij takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa.*

**Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime të tjera nuk pat, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së në orën 11:40 h.**

Procesmbajtësja,  
znj. Donjeta Morina



